



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM
NR. 1, DATË 19.07.2002

PËR
KRIJIMIN E KËSHILLAVE TË BASENEVE UJËMBLEDHËS

Në mbështetje të neneve 6 dhe 8 të Ligjit Nr.8093, dt.21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”, Vendimit Nr.5, dt.22.12.1998 “Për ndarjen e territorit të Republikës në basene ujëmbledhëse dhe për krijimin e agjencive të ujit për këto basene”, të Këshillit Kombëtar të Ujit, me propozim të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Të krijohen Këshillat e Baseneve Ujëmbledhës pranë 6 baseneve ujëmbledhëse të Republikës së Shqipërisë.

2. Numri i anëtarëve të KBU për çdo basen ujëmbledhës është:

- Baseni ujëmbledhës Drin-Bunë	25 antarë
- Baseni ujëmbledhës i Matit	19 antarë
- Baseni ujëmbledhës Ishëm-Erzen	25 antarë
- Baseni ujëmbledhës Shkumbin	25 antarë
- Baseni ujëmbledhës Seman	37 antarë
- Baseni ujëmbledhës Vjosë	31 antarë

3. Përbërja e antarëve të Këshillit të Basenit miratohet nga Kryetari i KBU dhe të jetë si vijon:

- Përfaqësues të pushtetit vendor (qarqet, bashkitë, komunat)
- Përfaqësues të ministrive dhe institucioneve që përbëjnë Këshillin Kombëtar të Ujit.
- Përfaqësues të përdoruesve të rezervave ujore (ujë të pijshëm, ujitje, hidroenergji, etj.)
- Përfaqësues të organizatave jo qeveritare që kanë objekt veprimtarie ujin.

4. Kryetarë të Këshillave të Baseneve Ujëmbledhës (KBU) të jenë si vijon:

- | | |
|---|---------------------------|
| - Kryetar i KBU për Basenin Drin-Bunë | Prefekti i Qarkut Shkodër |
| - Kryetar i KBU për Basenin Mat | Prefekti i Qarkut Lezhë |
| - Kryetar i KBU për Basenin Ishëm-Erzen | Prefekti i Qarkut Tiranë |
| - Kryetar i KBU për Basenin Shkumbin | Prefekti i Qarkut Elbasan |
| - Kryetar i - KBU për Basenin Seman | Prefekti i Qarkut Fier |
| - Kryetar i KBU për Basenin Vjosë | Prefekti i Qarkut Vlorë |

5. Kryetari i KBU, do të jetë në funksion për aq kohë sa Prefekti ushtron detyrën e ngarkuar.

6. Nënkryetari i Këshillit të Basenit Ujëmbledhës të zgjidhet nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës.

7. Sekretar i Këshillit të Basenit Ujëmbledhës të jetë Drejtori i Agjencisë së Ujit të Basenit Ujëmbledhës.

8. Anëtarët e Këshillit të Basenit Ujëmbledhës për punën e kryer shpërblehen me 2500 lekë për çdo mbledhje. Fondet për shpërblime sigurohen nga Sekretariati Teknik i KBU.

9. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit të përgatisë listën e Bashkive dhe të Komunave që përfshihen në secilin nga basenet ujëmbledhës të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Pandeli MAJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

NR.2, DATË 19.07.2002

PËR
MIRATIMIN E FORMULARËVE TË KËRKESËS PËR LEJE, AUTORIZIM
E KONCESION SI DHE FORMULARËVE TIP TË DEKLARIMIT, LEJES E
AUTORIZIMIT PËR PËRDORIMIN E REZERVAVE UJORE

Në mbështetje të neneve 6 dhe 20 të ligjit Nr.8093,datë.21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”, të pikave 5 dhe 19 të vendimit nr. 63,dt. 26.01.2001 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e kërimit , të shqyrtimit dhe dhënies së autorizimeve, të lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e rezervave ujore” me propozim të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Të miratojë formularët tip të kërkesës për përdorim të rezervave ujore me leje, autorizim e koncesion si dhe formularët (tip) të Deklarimit, Lejes dhe Autorizimit, që i bashkelidhen këtij vendimi::

Formulari A - *“Formular i deklarimit për përdorim të lire të rezervës ujore”.*

Formulari B - *“Formular i kërkesës për Leje për përdorim të rezervës ujore”.*

Formulari C - *“Formular i kërkesës për Koncesion për përdorim të rezervës ujore”.*

Formulari D - *“Formular i kërkesës për Autorizim, për kërkime, studime dhe eksplorime në rezervat ujore”.*

Formulari tip - *“Leje për përdorim rezerve ujore”*

Formulari tip - *“Autorizim për kërkime, studime dhe eksplorime në rezervat ujore”*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Pandeli MAJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

NR. 3, DATË 19.07.2002

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË SEKRETARIATIT
TEKNIK TË KESHILLIT KOMBËTAR TË UJIT, KËSHILLIT TË BASENIT
UJËMBLEDHËS DHE AGJENCISË SË UJIT

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr. 8093, dt.21.03.1996 “Për Rezervat Ujore” të vendimit nr.910. datë 30.12.1996 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit” dhe të pikës 7 të vendimit Nr. 5, dt. 22.12.1998 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për ndarjen e territorit të Republikës në basene ujëmbledhës dhe krijimin e agjencive të ujit për këto basene”, me propozim të Ministrit të Rregullimit të territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Të miratojë Rregulloren e Funkcionimit të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshillit të Basenit Ujëmbledhës dhe Agjencisë së Ujit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Pandeli MAJKO

& I. RREGULLORE

E SEKRETARIATIT TEKNIK TE KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

1. SEKRETARIATI TEKNIK I KJU-SË ZHVILLON AKTIVITETIN NË FUSHAT QË VIJON:

- 1.1 Zbaton dispozitat e Ligjit Nr.8093, dt.21.03.1996 “Për rezervat Ujore”, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe vendimet e këshillit kombëtar të Ujit (KKU).
- 1.2 Zbaton politikën kombëtare të rezervave ujore të miratuar nga KKU.
- 1.3 Përpilon inventarin qëndror të rezervave ujore si në aspektin e tyre sasior ashtu edhe atë cilësor, sipas rregullave që vendos KKU.
- 1.4 Harton raporte dhe jep opinione për çështje që kanë të bëjnë me rezervat ujore dhe ja parashtron sipas rastit KKU.
- 1.5 Jep Leje dhe Autorizime për përdorimin e ujit dhe për shkarkimet kur veprimtaria kryhet jashtë kufinjve të një baseni të vetëm.
- 1.6 Nxit studime, kërkime dhe novacione teknike që i shërbejnë zhvillimit e ruajtjes së rezervave ujore.
- 1.7 Nxit pjesmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e rezervave ujore.
- 1.8 Shqyrton planet financiare të hartuara nga Këshillat e Baseneve Ujëmbledhës (KBU) për financimin e investimeve të nevojshme në fushën e rezervave ujore.
- 1.9 Shqyrton kërkesat për përdorim rezervash ujore të cilat janë në kompetencë të KKU për tu miratuar (sipas klasifikimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave).
- 1.10 Përgatit materialet e mbledhjeve të KKU.
- 1.11 Në bashkëpunim me institucionet kërkimore -shkencore, lokale apo kombëtare, i propozon KKU fushat e kërkimit dhe studimit për rezervat ujore, si dhe fondet përkatëse për to.
- 1.12 Sekretariat nuk përgjigjet direkt për ndërtimin dhe funksionimin e veprave ose pajisjeve hidroteknike, por ka rolin e një këshilltari teknik duke bërë një harmonizim të problemeve ujore me mjetet financiare që nevojiten për zgjidhjen e tyre.
- 1.13 Rekomandon pranë KKU objektet më të rëndësishme që duhet të ndërtohen për çdo basen ujëmbledhës në bazë të një plani kombëtar të shfrytëzimit dhe të mbrojtjes së rezervave ujore, duke u nisur nga prioritetet e përcaktuara në ligj.
- 1.14 Analizon studimet e Agjencive të Ujit të Baseneve (Agjencitë) mbi shkallën e ndotjes së ujrave sipërfaqëore ose nëntokësore në bujqësi, industri, për qëllime komunale, etj. bazuar në këto analiza, Sekretariati i propozon KKU projekte dhe programe në shkallë kombëtare për ujlljen e ndotjes brenda kufijve të vendosura nga standarte shtetërore.

- 1.15 Sekretariati zbaton dispozitat e marrëveshjet ndërkombëtare për rezervat ujore ndërkufitare, palë e të cilave është Republika e Shqipërisë.
- 1.16 Sekretariati zbaton detyrat e ngarkuara nga KKU.

2. PROCEDURAT PËR APLIKIM PRANË SEKRETARIATIT TE KËRKESAVE PËR LEJE, AUTORIZIME DHE KONCESIONE

- 2.1 Subjektet shtetërore e privatë që duan të zhvillojnë aktivitete lidhur me përdorimin e ujit me Leje, Autorizime apo Koncesioni, kur veprimtaria parashikohet të kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm duhet të paraqitin një kërkesë në Sekretariat i cili ndjek procedurën e “shqyrtimit” dhe të “miratimit në parim” dhe dhënies së burimit për përdorim apo studim nga KKU.
- 2.2 Në rastet e “miratimit në parim” Sekretariati përgatit procedurën e tenderimit për burimin ujor sipas V.K.M. 63, dt. 26.01.2001 “Për procedurat e kërkimit , të shqyrtimit dhe dhënies së autorizimeve, të lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e rezervave ujore”, dhe Udhëzimit Nr. 2, dt.26.01.2001, “Për zbatimin e ligjit Nr.8093, dt.21.03.1996, “Për rezervat ujore” dhe të vendimit Nr. 63, dt.26.01.2001 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e kërkimit , të shqyrtimit dhe dhënies së autorizimeve, të lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e rezervave ujore”.
- 2.3 Sekretariati i paraqet KKU-së propozimin për anulimin e Lejeve, Autorizimeve të dhëna për veprimtari apo procese industriale, derdhjet e të cilave, pavarësisht nga trajtimi apo përpunimi paraqesin rrezik serioz për ndotjen e rezervave ujore, sistemin ekologjik, mjedisin si dhe rastet e tjera të parashikuara në ligj.

3. MASAT ADMINISTRATIVE

- 3.1 Për të gjitha shkeljet e evidentuara në shpërdorimin e rezervave ujore dhe materialet inerte të shfrytëzuara nga shtretërit e lumenjve merren masa dhe vendosen sanksione sipas ligjit Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”.
- 3.2 Inspektimin për përdorimin e rezervave ujore e kryejnë të gjithë punonjësit e Sekretariatit me autorizim të titullarit të dikasterit.
- 3.3 Për çdo inspektim dhe për shkeljet e konstatuara dërgon një raport pranë Kabinetit të Ministrit me propozim për masën e gjobës në mbështetje të ligjit Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”.
- 3.4 Për zbatimin e sanksionit vepohet sipas ligjit Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore” dhe dispozitave ligjore në fuqi.

- 3.5 Kundër vendimeve të Autoriteteve të Ujit veprohet sipas nenit 69 të ligjit Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”.

& II. RREGULLORE E KËSHILLIT TË BASENIT UJËMBLEDHËS

1. FUSHA E VEPRIMIT

- 1.1 KBU zhvillon aktivitetin e vet konform kësaj rregulloreje dhe në përputhje me ligjin Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- 1.2 KBU është autoriteti lokal përgjegjës për administrimin e rezervave ujore dhe luftës kundër ndotjes në basenin përkatës. KBU ka për detyrë të sigurojë:
- 1.2.1 Ruajtjen zhvillimin e shfrytëzimin sa më racional të rezervave ujore brenda kufijve të basenit të vet ujëmbledhës.
- 1.2.2 Shpërndarjen e drejtë të rezervave ujore brenda kufirit të basenit të vet ujëmbledhës sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre.
- 1.2.3 Mbrojtjen e rezervave ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe harxhimet mbi nevojat faktike.

2. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

- 2.1 Numri i anëtarëve dhe përbërja e KBU përcaktohet me vendim të KBU.
- 2.2 Afati i mandateve të anëtarëve dhe kryetarit të KBU gjithashtu përcaktohen me vendim të KBU.

3. MBLEDHJA E KBU

- 3.1 KBU mbledhet jo më pak se katër herë në vit. Mbledhja e KBU mund të bëhet dhe jashtë radhe në rastet kur kjo kërkohet nga kryetari i KBU, nga shumica e anëtarëve të KBU ose nga Drejtori i Sekretariatit Teknik të KBU.
- 3.2 Mbledhja e KBU është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të tij.
- 3.3 Në mbledhjen e KBU përveç anëtarëve të saj merr pjesë pa të drejtë vote Drejtori i Agjencisë së Ujit të Basenit Ujëmbledhës (tani e tutje “Drejtori i Agjencisë”). Gjithashtu në mbledhje mund të marrin pjesë pa të drejtë vote ekspertë apo administratorë të fushës së studimit

- ose të shfrytëzimit të rezervave ujore, si dhe përsone të tjerë të interesuar për probleme projektesh që do të trajtohen.
- 3.4 Në mbledhje KBU trajton probleme që janë objekt i ligjit Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”.

4. RENDI I DITËS I MBLEDHJES SË KBU

- 4.1 Rendi i ditës dhe materialet që do të diskutohen në mbledhjen e KBU përgatiten nga Drejtori i Agjencisë, duke përfshirë këtu materialet që mund të dërgojnë anëtarët e KBU për t'u shqyrtuar në mbledhjen e KBU.
- 4.2 Pas miratimit nga kryetari i KBU, rendi i ditës së bashku me materialet përkatëse dërgohen me shënimin “*Personale*” anëtarëve të KBU, jo më pak se pesë ditë përpara ditës së mbledhjes. Dokumentacioni i plotë teknik i materialeve vihet në dispozicion të anëtarëve të KBU, pranë Agjencisë së Ujit të Basenit Ujëmbledhës (Agjencisë).
- 4.3 Rendi ditës së mbledhjes si rregull përbëhet nga tre pjesë:
- 4.3.1 Miratimi i projekt-akteve në zbatim të ligjit Nr.8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore” (plani i rezervave ujore, plani financiar, etj).
- 4.3.2 Shqyrtimi i kërkesave për përdorim (shkarkim) rezervash ujore sipas klasifikimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.63, datë 26.01.2001 lidhur me kopetencat për administrimin e rezervave ujore.
- 4.3.3 Raportime informacione apo diskutime dhe probleme të tjera që lidhen me rezervat ujore.
- 4.4 Drejtori i Agjencisë informon me shkrim brenda datës dhjetë të çdo tremujori Drejtorin e Sekretariatit Teknik të KBU mbi veprimtarinë e Agjencisë.
- 4.5 Kryetari i KBU ka të drejtë të kërkojë informacione nga Drejtori i Agjencisë, kur e shih të nevojshme, për problemet që trajton Agjencia.

5. MARRJA DHE SOLIDARITETI I VENDIMEVE

- 5.1 Vendimet e KBU merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë, përcaktuëse është vota e kryetarit të KBU.
- 5.2 Projekt-aktet dhe kërkesat për përdorim (shkarkime) të rezervave ujore që shqyrtohen në mbledhjen e KBU mund të miratohen, të ndryshohen, të shtyhen për shqyrtim të mëvonshëm, ose të mos miratohen. Për të ndihmuar KBU në marrjen e vendimeve, pranë

- Agjencisë krijohet Këshilli Konsultativ Teknik, përbërja e të cilit përcaktohet nga KBU.
- 5.3 Kryetari i KBU ose Drejtori i Agjencisë, e mbledh Këshillin Konsultativ Teknik sa herë e sheh të nevojshme.
 - 5.4 Aktiviteti i mbledhjes ku përfshihen: vlerësimet, debatet, vendimet dhe raporti përfundimtar i mbledhjes së KBU janë konfidenciale.
 - 5.5 Anëtarët e KBU duhet të respektojnë vendimin e marrë në mbledhjen e KBU. Në mënyrë të veçantë ato duhet të mënjanojnë shprehjet e mospajtimit, të mbrojnë ose të përkrahin vendimin e marrë, pavarësisht nga fakti nëse kanë marrë pjesë në mbledhje apo jo dhe nëse kanë votuar pro ose kundër tij.
 - 5.6 Çdo anëtar duhet të njoftojë Kryetarin e KBU para mbledhjes kur ai, ose familja e tij, ka interesa për ndonjë çështje që shqyrtohet në mbledhjen e KBU dhe nuk duhet të marrë pjesë në diskutimin e çështjes, nuk duhet të votojë për të e as të ndikojë në qëndrimin e anëtarëve të tjerë.

6. NËNSHKRIMI I VENDIMEVE, SHPËRNDARJA DHE ARKIVIMI I TYRE

- 6.1 Në mbledhjen e KBU mbahet procesi i cili firmosët nga Drejtori i Agjencisë dhe nga Kryetari i KBU.
- 6.2 Drejtori i Agjencisë drejton procesin e nënshkrimit të vendimeve të KBU. Ato siglohen nga Drejtori i Agjencisë dhe firmosen nga Kryetari i KBU.
- 6.3 Drejtori i Agjencisë merr masa për shpërndarjen zyrtare të akteve brenda dy javëve nga nënshkrimi i tyre, duke i dërguar nga një kopje të aktit secilit anëtar të KBU dhe një kopje Sekretariatit Teknik të KKU. Dy kopje arkivohen pranë arkivës së Agjencisë së Ujit.
- 6.4 Pas mbledhjes së KBU, Drejtori i Agjencisë harton raportin përfundimtar, i cili nënshkruhet nga Drejtori i Agjencisë dhe nga Kryetari i KBU brenda 10 ditëve nga data e mbledhjes.
- 6.5 Raporti përfundimtar përmban pjesmarrjen në mbledhje, rendin e ditës, konkluzionet përkatëse për çdo projekt të shqyrtuar, shënimin për miratimin pa ose me ndryshime të tekstit, duke evidentuar këtu qartë ndryshimet, shënimin për refuzim, shtyerjen për shqyrtim të mëvonshëm ose mosmiratimin e tij. Në raport përfshihen edhe probleme të tjera të diskutuara në mbledhjen e KBU si dhe konkluzione për ndjekjen e tyre.
- 6.6 Raporti përpilohet në tre kopje, njëra prej të cilave mbahet në zyrën e Drejtorit të Agjencisë, tjetra në zyrën e kryetarit të KBU dhe kopja e tretë i dërgohet Sekretariatit Teknik të KKU.

8. PARAQITJA E MATERIALEVE PËR MBLEDHJE

- 8.1 Projekt-akti që ka të bëjë me kuadrin ligjor e nënligjor, me politikën e administrimit të ujit, apo me aktivitete të tjera të karakterit financiar, mund të propozohet nga çdo anëtar i KBU, duke ja dërguar, të paktën një muaj para mbledhjes së radhës së KBU, Drejtorit të Agjencisë në dy kopje. Ky i fundit vepron konform pikës 4.1 të rregullores.
- 8.2 Propozimi për një projekt duhet të përmbajë, përveç projektit, dhe relacionin shpjegues së bashku me shkresën përcjellëse të nënshkruar nga propozuesi.
- 8.3 Drejtori i Agjencisë përpilon relacionin përkatës, për çdo kërkesë për përdorim (shkarkim) të rezervave ujore, duke shprehur dhe mendimin e agjencisë, e sipas rastit, edhe të Këshillit Konsultativ.

9. SHQYRTIMI I KËRKESAVE PËR PËRDORIM (SHKARKIM) REZERVASH UJORE

91. Procedurat për aplikime për kërkesa për përdorim rezervash ujore kryen konform Rregullores së Agjencisë së Ujit.
92. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave kryhet konform VKM përkatëse, rregullores së KBU dhe Agjencisë së Ujit.

& III. RREGULLORE E AGJENCISË SË UJIT

1. FUSHA E VEPRIMIT

Agjencia zhvillon aktivitetin e vet në fushat si vijon:

- 1.1 Zbaton dispozitat e Ligjit Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe vendimet e Këshillave të Baseneve Ujëmbledhës (KBU).
- 1.2 Përpilon projektin e planit për rezervat ujore për basenin e vet dhe e paraqet për miratim në KBU dhe pastaj nëpërmjet Sekretariatit Teknik në KBU.
- 1.3 Brenda kufinjve të basenit të vet, harton inventarin e rezervave ujore në sasi cilësi dhe i azhuron ato vazhdimisht.
- 1.4 Nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e rezervave ujore.
- 1.5 Ndjek përmbushjen e detyrimeve financiare të përdoruesve (shkarkuesve) të rezervave ujore.

- 1.6 Propozon plane financiare për financimin e investimeve të nevojshme në fushën e rezervave ujore.
- 1.7 Shqyrton kërkesat për përdorim rezervash ujore konform paragrafit 3 të kësaj rregulloreje.
- 1.8 Përgatit materialin për mbledhjen e radhës së KBU.
- 1.9 Nxist studime, kërkime dhe novacione teknike, që i shërbejnë zhvillimit dhe ruajtjes së rezervave ujore.
- 1.10 Harton raporte dhe jep opinione për çështjet që kanë të bëjnë me rezervat ujore të basenit dhe ja parashtron, sipas rastit, KBU ose Sekretariatit Teknik të KBU.
- 1.11 Në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore, lokale apo kombëtare, përcakton fushat e studimit të rezervave ujore të basenit ujëmbledhës, fondet e nevojshme për to dhe mbikqyr zbatimin e projekteve.
- 1.12 Agjencia nuk përgjigjet direkt për ndërtimin dhe funksionimin e veprave ose pajisjeve hidroteknike, por ka rolin e një këshilltari teknik duke bërë një harmonizim të problemeve ujore me mjetet financiare që nevojiten për zgjidhjen e tyre.
- 1.13 Agjencia rekomandon punimet apo objektet me të nevojshme për komunat, bashkitë apo prefekturat që bëjnë pjesë në basenin ujëmbledhës, për zgjidhjen e problemeve që lidhen me rezervat ujore.
- 1.14 Agjencia në bashkëpunim me organizmat qendrore dhe lokale, shqyrton projekte dhe programe për planifikimin e ujitjes, kullimit, mbrojtjes së brigjeve të lumenjve, liqeneve, etj. dhe ja paraqit për miratim Këshillit të Basenit.
- 1.15 Në bazë të studimeve, përkatëse, hidrologjike dhe hidrodjeologjike, shpall zonat e mbrojtjes sanitare përreth burimeve ujore dhe i bën ato publike për autoritetet përkatëse dhe publikun e gjerë.
- 1.16 Agjencia me anën e institucioneve shtetërore dhe private të specializuara, kryen studime mbi shkallën e ndotjes së ujrave nga përdorimet në bujqësi, industri, për qëllime komunale, etj. Bazuar në këto studime, agjencia i propozon KBU projekte dhe programe për uljen e shkallës së ndotjes brenda kufijve të vendosura nga standartet shtetërore.

2. PROCEDURAT E APLIKIMIT PRANË AGJENCISË PËR LEJE, AUTORIZIM APO KONCENSION

- 2.1 Subjektet private të cilat duan të zhvillojnë aktivitete, që lidhen me përdorimin e ujit me leje, autorizim, me bazë koncesioni, apo me bazë deklarimi, duhet të paraqiten në Agjenci për të marrë formularët e nevojshëm që duhen plotësuar për këtë qëllim.

- 2.2 Materiali që dorëzohet pranë Agjencisë duhet të jetë në gjuhën shqipe (ose i përkthyer e noterizuar) në përputhje me vendimet përkatëse të këshillit të ministrave si dhe konform formularëve të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit dhe udhëzimeve të Sekretariatit Teknik të K KU.
- 2.3 Agjencia regjistron materialin e përfaqituar, sipas rastit, në regjistrin e posaçëm për vetë Agjencinë ose në atë të materialeve që duhen shqyrtuar nga Sekretariati Teknik i K KU, bazuar në klasifikimin përkatës të miratuar nga K KU.
- 2.4 Përveç deklarimeve, aplikanti paguan për çdo lloj kërkesë konform vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.
- 2.5 Dokumentacioni i plotë i kërkesës për leje ose autorizim duhet të dorëzohet pranë Agjencisë dy muaj para datës së mbledhjes së KBU. Në rast se kërkesa e bërë nga ana e subjektit nuk plotëson kërkesat dhe udhëzimet e dhëna nga Agjencia, materiali i kthehet subjektit kërkuar për t'u plotësuar. Sa herë që materiali kthehet i korrigjuar, afati i ri fillon me dorëzimin e tij pas korrigjimit.
- 2.6 Agjencia shqyrton dokumentacionin e plotë të kërkesave për leje, autorizime dhe koncesione brenda kompetencave të miratuara në K KU për KBU, duke përpiluar një relacion të shkurtër për sejcilën kërkesë dhe duke shprehur me shkrim dhe mendimin e saj, e sipas rastit edhe të Këshillit Konsultativ Teknik. Miratimi në parim i Këshillit Konsultativ së bashku me oponentat përkatëse dhe relacionin shoqëruar të Agjencisë dërgohen për shqyrtim në mbledhjen e radhës së KBU, sipas rregullores së KBU.
- 2.7 Agjencia kur e sheh të nevojshme ka të drejtë të kërkojë opoenca nga institucione të specializuara për kërkesat për përdorim rezervash ujore. Për to kryhen pagesa konform akteve në fuqi.
- 2.8 Materialet për kërkesa për përdorim rezervash ujore që shqyrton KBU ndahen në dy tipe:
 - 2.8.A1 Kur KBU është dakort me kërkesën -merret vendimi për miratim. Në këtë rast zbardhja e vendimit kryhet brenda 15 ditëve nga data e mbledhjes së KBU dhe leja apo autorizimi duhet të jenë gati për t'ju dorëzuar aplikantit brenda një muaji nga data e mbledhjes. Vendimi dhe leja apo autorizimi firmosen nga Drejtori i Agjencisë dhe Kryetari i KBU.
 - 2.8.A2 Kur KBU ka vërejtje lidhur me dokumentacionin e kërkesës -merret vendimi *miratim me kusht*. Materialet për të cilat ka vërejtje i kthehen aplikantit për plotësimin e vërejtjeve, brenda 10 ditëve nga data e mbledhjes. Aplikanti duhet t'i kthejë në Agjenci materialet e plotësuara brenda 20 ditëve, në tre kopje. Nëse plotësimi është bërë në rregull Përgjegjësi i Agjencisë ia paraqet Kryetarit të KBU për firmë, së bashku me vendimin dhe lejen apo

autorizimin e sigluar prej tij, brenda 15 ditëve nga dorëzimi i mëtarialit me vërejtjet e plotësuar. Leja apo autorizimi duhet të jenë gati për t`ju dorëzuar aplikantit brenda 15 ditëve pas dërgimit për firmë kryetarit të KBU. Nëse plotësimi nuk është bërë në rregull i gjithë materiali i kthehet aplikantit për të nisur procedurën nga fillimi.

- 2.8.B Kërkesa që KBU i shqyrton e jep miratimin në parim dhe pastaj dërgohen për miratim në autoritetet e larta të ujit.
Për këto lloj kërkesash vendimi në parim zbardhet brenda 15 ditëve dhe brenda 20 ditëve dokumentacioni i plotë, i firmosur nga Drejtori i Agjencisë dhe Kryetari i KBU, i nisët zyrtarisht Sekretariatit Teknik për veprime të mëtejshme. Në rast se dhe për këtë lloj miratimi ka vërejtje para nënshkrimit nga Drejtori i Agjencisë dhe Kryetari i KBU, veprhët si në pikën 2.8.A2.
- 2.9 Agjencia i dorëzon aplikantit lejen ose autorizimin kundrejt kundrejt pagesës për shpenzimet administrative, sipas tarifave të miratuara nga Këshilli i Ministrave.
- 2.10 Leja apo autorizimi shoqërohen me udhëzimet përkatëse për përdorimin e ujit, që janë pjesë përbërëse e lejes apo autorizimit.
- 2.11 Lejet e autorizimet nuk mund të refuzohen nga agjencia pa u bazuar në vendimin e marrë në KBU. Në rast se këkesa është e jashtëligjshme Agjencia kthen përgjigje negative subjektit kërkues duke sqaruar qrsyët e mospranimit.
- 2.12 Agjencia i paraqet KBU dhe nëpërmjet saj, në rast nevoje, organit kompetent propozimin për anullimin e lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve (të dhëna) për veprimtari apo procese industriale, derdhjet e të cilave, pavarësisht nga trajtimi apo përpunimi, paraqesin rrezik serioz në ndotjen e rezervave ujore, sistemin ekologjik dhe mjedisin si dhe për rastet e tjere që parashikohen në ligjin Nr.8093,date 21.03.1996 "Për Rezervat Ujore".
- 2.13 Për çdo shfrytëzim burimi ujq Agjencia verifikon mënyrën e përdorimit të burimit ujq, sipas parashikimit në leje apo koncesion apo aktivitet të përshkruar në autorizim.
- 2.14 Agjencia kërkon asistencë teknike nga Sekretariati Teknik apo institucione të tjera të specializuara për zgjidhjen e problemeve teknike, financiare dhe juridike që i lindin asaj gjatë aktivitetit.
- 2.15 Agjencia kontrollon dhe mbledh rregullisht pagesat për përdorimin e rezervave ujore sipas tarifave të vendosura me vendim të Këshillit të Ministrave.
- 2.16 Çdo aktivitet financiar Agjencia e Kryen sipas planeve dhe udhëzimeve të Këshillit Kombëtar të Ujit.
Shpenzimet për oponencat apo për veprime të tjera që kryen Agjencia dhe KBU për shqyrtimin dhe miratimin e kërkësave për leje,

përfshihen në pagesat për shpenzimet administrative sipas akteve të Këshillit të Ministrave.

3. MASAT ADMINISTRATIVE

- 3.1 Për të gjitha shkeljet e evidentuara në shfrytëzimin e rezervave ujore dhe materialeve inerte të shtretërve të lumenjve merren masa dhe vendosen sanksione siaps ligjit Nr.8093, datë.21.03.1996 “Për Rezervat Ujore” dhe ligjeve të tjera në fuqi.
- 3.2 Inspektimin për përdorimin e rezervave ujore e kryejnë inspektorët e ujit. Statusin e inspektorit të ujit e kanë të gjithë punonjësit e Agjencisë dhe personat e autorizuar nga KBU.
- 3.3 Çdo inspektor uji për shkeljet e konstatuara dërgon një raport pranë sektorit ekonomik të Agjencisë. Bazuar në këtë raport , ku përcaktohet dhe masa e gjobës apo sanksionit, sektori ekonomik i dërgon faturën kundravajtësit përkatës.
- 3.4 Për zbatimin e sanksioneve veprohet sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.
- 3.5 Ankesa ndaj vendimeve autoriteteve të ujit kryhet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTR TË UJIT

Pandeli MAJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

NR. 4, DATË 19.07.2002

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË STUDIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË
UJËRAVE NËNTOKËSORE NËPËRMJET PUSEVE TË SHPIMIT

Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit Nr.8093, dt.21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”, me propozim të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Të miratojë Rregulloren e studimit dhe shfrytëzimit të ujrave nëntokësore nëpërmjet puseve të shpimit.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Pandeli MAJKO

RREGULLORE
PËR STUDIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E UJRAVE NËNTOKËSORE
NËPËRMJET PUSEVE TË SHPIMIT

Rregullorja për studimin dhe shfrytëzimin e ujrave nëntokësore nëpërmjet puseve të shpimit u përpilua duke u bazuar në Ligjin Nr.8093, date 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore” dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton kërkesat që duhet të mbajnë përasysh personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, që dëshirojnë të studjojnë apo përdorin rezerva ujore nëpërmjet puseve të shpimit.

Neni 2

Hartuesi i projektit të studimit apo shfrytëzimit të ujrave nëntokësore, nëpërmjet pusit të shpimit, duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale të projektimit, *Kategoria 11*.

Neni 3

Pajisja me licensë

Shpimi i pusit për studim apo shfrytëzim ujrash nëntokësore kryhet nga një përsone fizik apo juridik i pajisur me licensë profesionale, sipas *tabelës së klasifikimit të punimeve të zbatimit, pika 9 f “shpime dhe puse hidrogjeologjike”* lëshuar nga Komisioni i Licensave pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Neni 4

Subjekti që studion apo përdor rezervë ujore nëntokësore duhet të jetë i pajisur me Autorizim apo Leje nga Autoritetet e Ujit sipas tipit të aktivitetit që do të kryejë.

Neni 5

Kërkesa për leje, autorizim apo koncesion për shfrytëzim ujrash nëntokësore nëpërmjet puseve të shpimit, aplikohet pranë autoriteteve të ujit.

Neni 6 Përmbajtja e projektit

Projekti i shpimit dhe shfrytëzimit të pusit duhet të përmbajë detyrimisht:

- Mënyrën e kryerjes së shpimit dhe diametrin e pusit.
- Kollonën e tubacioneve të vendosura në pus, thellësinë e vendosjes së filtrit, gjatësinë dhe tipin e filtrit të vendosur.
- Prerjen gjeologo litologjike të pusit me përshkrimin e detajuar të depozitimeve të përshkruara si dhe thellësinë e çdo depozitimi.
- Trashësinë e shtresës ujëmbajtëse.
- Koeficientin e filtrimit të shtresës ujëmbajtëse.
- Llojin e pompës që do të instalohet dhe kapacitetin e saj.
- Sasinë e ujit që del nga pusi në l/sek apo m³/24orë.

Neni 7

Brenda 2 muajve nga përfundimi i shpimit, shpuesi i pusit duhet t'i dorëzojë zotëruesit të lejes së shfrytëzimit raportin hidrogjeologjik i cili duhet të përmbajë:

- Të dhëna të përgjithshme hidrologjike (hidrografi, klimë, etj.)
- Përshkrimin e punimeve të kryera në burimin ujqor (shpime, galeri, pompime, etj.)
- Rezultatet e punimeve të kryera, përfshirë % e sigurisë.
- Të dhëna fiziko-mekanike dhe bakterologjike për burimin ujqor (analiza laboratorike) dhe komentet për to.
- Rekomandime për regjimin e shfrytëzimit të pusit dhe për vendosjen e zonave sanitare (kur përdoret për pirje), etj.

Neni 8

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të ujrave nëntokësore, një kopje origjinale të raportit duhet t'ja dorëzojë autoriteteve ku ka aplikuar, jo më vonë se 2 muaj nga përfundimi i shpimit.

Neni 9

Autoriteti i ujit ka të drejtë që, nëpërmjet specialistëve të saj, të kontrollojë periodikisht debitin e ujit të pusit që shfrytëzohet me anë të aparateve matës që detyrimisht i vendos lejembajtësi.

Neni 10

Kur pusi nuk jep rezultatin e duhur ose për ndonjë arsye tjetër duhet të braktiset, trangu i tij duhet të çimentohet përpara likujdimit të punimeve fushore dhe për këtë kërkon verifikim nga autoritetet e ujit.

Neni 11

Tarifat mbi shfrytëzimin e ujit nëntokësor

Zotëruesi i pusit të shfrytëzimit të ujit nëntokësor duhet të paguajë tarifën në afatin e caktuar, për sasinë e konsumuar, sipas tabelës së tarifave të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 12

Sanksionet

Për shkeljet e konstatuara dhe moszbatim të rregullave të përcaktuara më sipër, zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të ujrave nëntokësore, dënohet sipas pikave të nenit 65 të Ligjit Nr.8093, date 21.03.1996 "Për Rezervat Ujore".

K R Y E T A R I

Pandeli MAJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

NR. 5, DATË 19.07.2002

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIMIN E UJIT TË DISA BURIMEVE
EKZISTUESE, TË SHFRYTËZUARA NGA NDËRMARRJA E
UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMEVE ELBASAN, SHOQËRISË
“ELBER” SH.P. K MBI BAZËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”,
NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, MINISTRISË SË
EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT, BASHKISË SË QYTETIT
TË ELBASANIT DHE BERLINWASSER INTERNATIONAL GmbH
(SHOQËRIA “ELBER” SH.P.K)

Mbështetur në nenin 14, 18 dhe 21 të ligjit nr.8093, dt.21.03.1996 “Për Rezervat Ujore” dhe nenin 5 të ligjit nr. 8783, dt. 07.05.2001 “Për miratimin e “Marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT”, ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Bashkisë së qytetit të Elbasanit dhe Berlinwasser International GmbH, për Ndërmarrjen e Ujësjiellësit dhe Ujë-Kanalizime Elbasan” si dhe dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për koncesionarin e kësaj marrëveshje, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Miratimin e lejes për përdorimin e ujittë disa burimeve ekzistuese, me prurje maksimale 1175 l/sek, mbi bazën e koncesionit të dhënë më parë për ujësjiellësa publike dhe shkarkime në formën “BOT” për ndërmarrjene ujësjiellësit dhe të ujë-kanalizimeve Elbasan, ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Bashkisë së Qytetit të Elbasanit dhe Berlinwasser International GmbH (shoqëria “ELBER” sh.p.k), si vijon:
 - a. Katër burime në fshatin Mengele, me prurje maksimale 545 l/sek, për ujësjiellësin e rrethit të Elbasanit, të cilat do të furnizojnë Qytetin e Elbasanit.

- Burimi nr. 1, me prurje maksimale 115 l/sek
 - Burimi nr. 2, me prurje maksimale 115 l/sek
 - Burimi nr. 3, me prurje maksimale 115 l/sek
 - Burimi nr. 4, me prurje maksimale 200 l/sek
- b. Tre burime në zonën e Frigoriferit, me prurje maksimale 330 l/sek, për ujësjellësin e rrethit të Elbasanit, të cilat do të furnizojnë Qytetin e Elbasanit.
- Burimi nr. 4, me prurje maksimale 60 l/sek
 - Burimi nr. 5, me prurje maksimale 135 l/sek
 - Burimi nr. 6, me prurje maksimale 135 l/sek
- c. Tre burime në zonën e Krastës së Vogël, me prurje maksimale 300 l/sek, për ujësjellësin e rrethit të Elbasanit, të cilat do të furnizojnë Qytetin e Elbasanit.
- Burimi nr. 7, me prurje maksimale 60 l/sek
 - Burimi nr. 8, me prurje maksimale 80 l/sek
 - Burimi nr. 9, me prurje maksimale 160 l/sek
2. Mbledhje, depozitime dhe shkarkime të ujërave të zeza (maksimale 10751 l/sek) të Qytetit të Elbasanit.
- Zona nr. 1, 358 l/sek
 - Zona nr. 2, 358 l/sek
 - Zona nr. 3, 359 l/sek
3. Berlinwasser International GmbH (Shoqëria “ELBER” sh.p.k), krahas zbatimit të marrëveshjes së koncesionit, është e detyruar të zbatojë dispozitat e ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, lidhur me përdorimin e ujit.
4. Bashkëlidhur këtij vendimi janë skicat nr. 1, 2 për furnizimin me ujë të pijshëm dhe skicat nr. 3, 4 për trajtimin e ujërave të zeza.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Pandeli MAJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

NR. 6, DATË 19.07.2002

PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KONSORCIUMIT “ACQUEDOTTO
PULIESE” PËR PROJEKTIN E UJËSJELLËSIT SHQIPËRI – ITALI

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr.8093, dt.21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”, me propozim të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Të miratojë në parim kërkesën e paraqitur nga konsorciumi “Acquadotto Puliese” për projektin e ujësjellësit Shqipëri – Itali dhe të autorizojë Ministrin e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të negociojë dhe të përgatisë materialin përfundimtar, për shqyrtim në Këshillin Kombëtar të Ujit.
2. Ngarkohet Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të krijojë grupin e punës për negociimin e projektit me qëllim krijimin e një projekti integruar në të cilin të përfshihen edhe hartimi i masterplanit të zhvillimit urban turistik të rajonit Vlorë – Sarandë, ndërtimi i infrastrukturës rrugore të rivierës së Jugut të Shqipërisë, ndërtimi i linjës parësore të furnizimit me ujë të rajonit të përfshirë në studim, ndërtimi i rrjetit transmetues të energjisë elektrike dhe telefonike etj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Pandeli MAJKO

